



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:149383

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06549276

PPP.nr.41/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. rr. “Nëna Terezë”, nr.36, Prishtinë, kundër debitorit B. (F.) M. nga fshati B..., Komuna e P..., duke vendosur sipas propësimit të debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, P.nr.1494/18 të datës 18.12.2018, jashtë seancës, me datë 04.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET i bazuar propësimi i debitorit B. (F.) M. nga fshati B..., Komuna e P..., ashtu që **ANULOHET** Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.1494/2018 i datës 18.12.2020, i lejuar nga Zyra e Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, dhe **REFUZOHET** propozimi për përmbartim i paraqitur me datë 18.12.2018, nga kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. rr. “Nëna Terezë”, nr.36, Prishtinë.

II. DETYROHET kreditori t’i paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 582.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbartimit.

A r s y e t i m

Kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. rr. “Nëna Terezë” nr.36 Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstraktit nga librat afarist, ka parashtruar propozim për përmbarrim pranë Përmbarruesit Privat Ilir Mulhaxha në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori B. (F.) M. nga fshati B..., Komuna e P..., që në emër borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike për periudhën prej 04.10.2007 deri me 20.03.2013, ta paguaj shumën prej 2,051.15 €uro me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbarruesi privat Ilir Mulhaxha, më Urdhrin P.nr.1494/18 të datës 18.12.2018 e ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit të përmbarruesit privat dhe e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e përmbarruesit privat me pretendimet se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar duke e bazuar në nenin 360 par.1 të LMD-së, pasi që ka bërë propozim për përmbarrim me datë 18.12.2018 për periudhë prej datës 04.10.2007-20.03.2013 dhe meqenëse kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit, debitori nuk do të lëshohet në çështjet e tjera, pasi që nuk janë relevante kur debitori nuk ka më detyrim, duke i propozuar gjykatës që prapësimin ta pranoj si të bazuar dhe ta anuloj dhe propozimin ta refuzoj si të pabazuar për shkak të parashkrimit të kërkesës së debitorit, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke pretenduar se tek Kriteri Minimal është i precizuar borxhi kumulativ jo i ndarë nga faturë për faturë mujore, duke shtuar se borxhi i krijuar nuk është parashkruar pasi që debitori ka nënshkruar Kontratë për pagesën e borxhit, Deklaratën mbi dakordimin e borxhit me datë 22.08.2016, ndërsa me datë 10.05.2018 ka bërë pagesën e energjisë për KEK kësti 17, me qëllim të përfitimit nga falja sipas dispozitave të Ligjit për Faljen e Borxhit Publike, e cila kontratë Ex lege sipas nenit 368 të LMD-së shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhër.

Gjykata, me aktvendimin PPP.nr.54/2019 të datës 20.12.2019 ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.1494/2018 të datës 18.12.2018. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit AC.nr.1255/2020 të datës 14.06.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata, në rivendosje me aktvendimin PPP.nr.48/2022 të datës 13.06.2023 ka hedhur poshtë propozimin e kreditorit. Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit CAP.nr.1182/2023 të datës 15.10.2024 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit për sa i për ketë afateve të parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrimin të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare nr.29/78, kohë në të cilën ka qenë në fuqi ky ligj, në të cilin përcaktohet se: “Parashkruhen për një vjet: kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”. Kurse neni 361 i LMD-së rregullon se: “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Në këtë drejtim, kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga momenti arritje së secilës kërkesë për pagesë veç e veç. Ndërsa fatura e fundit ka qenë e datës 20.03.13, kurse propozimi për përmbarim nga kreditori paraqitet me datë 18.12.2018. Sipas nenit 43 par. 4 të LPP-së Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri.

Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim. Andaj, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat.

Gjykata, analizoi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapsim, mirëpo te njëjta nuk kishin rendësi vendimtare në vendosjen sipas prapësimit, ngase kërkesa ishte përfshirë në parashkrim. Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj anuloi urdhrin përmbarimor.

Gjykata vendos si në pikën II që kreditori t'i bartë shpenzimet e procedurës duke u bazuar në dispozitën ligjore konform nenit 13 të LPP-së, neneve 449 par.2 dhe 453 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata, bazuar në nenin 43 par.4, në lidhje me nenin 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.41/24, me datë 04.12.2024

G j y q t a r j a

Adelina Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.